



## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

141/20

Data/Datum.

08.10.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 141/16

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues si dhe z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 879/16, të dt: 13 shkurt 2020, ku është aprovuar kërkesëpadia e paditësit "Rosa Security" shpk me seli në Prizren, ndërsa është anuluar vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. 141/16, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit regional të Prizrenit dhe Vushtrisë" me numër të prokurimit 220/16/002/211, të iniciuar nga AK- "Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës", me dt: 10 tetor 2020, merr këtë vendim:

## V E N D I M

- I. **Zbatohet** vendimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative-Prishtinë me A. nr. 879/16 i datës 13 shkurt 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit regional të Prizrenit dhe Vushtrisë" me numër të prokurimit 220/16/002/211, të iniciuar nga AK- "Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.
- II. **Mbetet në fuqi**, vendimi i autoritetit kontraktues- SHSKUK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit regional të Prizrenit dhe Vushtrisë" me numër të prokurimit 220/16/002/211, duke e pasur parasysh faktin se operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë ka nënshkruar kontratën dhe është implementuar kontrata.

## A R S Y E T I M

Autoriteti kontraktues-Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me datën 06 maj 2016, ka bërë publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit regjional të Prizrenit dhe Vushtrisë” me numër të prokurimit 220/16/002/211. Kundër vendimit të AK-së fillimisht ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në autoritet kontraktues operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit “Rosa Security” (në tekstin e mëtejshëm referuar: paditësi). AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të autoritetit kontraktues dhe kundër vendimit për refuzim ka paraqitur ankesën në OSHP paditësi “Rosa Security”.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, ka kërkuar nga KRPP, sqarim lidhur me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës ditën e premte në ueb-faqen e KRPP-së, për të pasur të qartë se a fillon afati ditën e shtunë (ditë vikendi) apo prej ditës së hënë (ditë pune), pasi që me nenin 5 të LPP-së shkruan, **citat**: Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë një ditë pune dhe të përfundojnë një ditë pune. Afati kohor shkon deri në ora 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti Kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai të mos jetë më herët se ora 12:00 të ditës së skadimit.

Në përgjigjen e datës 23 maj 2016, KRPP ka sqaruar: “Konform nenit 87 par 2, nën-par 2. 7 të LPP-së, KRPP ofron këtë interpretim ligjor: KRPP konsideron se Publikimi i Njoftimit për dhënie të kontratës është publikuar ditën e premte, edhe pse dita e parë e publikimit është “zero”, është ditë pune, andaj mendojmë se nuk do të ishte në kundërshtim me pasuesin e nenit 5 të LPP-së, ku thuhet se afatet kohore duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune, andaj publikimi është në një ditë pune, dhe duhet të përfundon në një ditë pune, që do të thotë se rrjedha e afatit sipas opinionit tonë, do të fillojë nga dita e shtunë”.

Pasiqë OSHP ka pranuar përgjigjen e KRPP-së ka sqaruar për OE ankues se ankesa hudhet poshtë si e palejuar, pasi që njoftimi për dhënie të kontratës është publikuar me datën 06 maj 2016 ndërsa kërkesa për rishqyrtim në autoritet kontraktues është bërë me datën 12 maj 2016, duke kaluar kështu afatin ligjor për rishqyrtim sipas nenit 108/A pika 3. 2 të LPP-së si dhe nenit 4 paragrafi A të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së parashtrim të ankesave në OSHP dhe vlera të tarifave të ankesave

Kundër vendimit të OSHP-së OE “Rosa Security” shpk me datën 10 qershor 2016 ka iniciuar padi – konflikt administrativ në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, të cilën padi e ka plotësuar me datën 20 qershor 2020.



Gjykata Themelore Departamentit për Çështje Administrative, me dt: 03 shkurt 2020, ka marr Aktgjykimin me A. nr. 879/16, ku ka e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit "Rosa Security", ndërsa ka anuluar vendimin e OSHP-së me nr. 141/16 i datës 01 qershor 2016. Gjykata vlerëson se, nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se në nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve që duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Sipas gjykatës nga i tërë arsyetimi vërtetohet se e paditura ka vendosur për ankesën e paditësit në mënyrë meritore, përderisa në diapozitivin e vendimit, ankesën e paditësit e ka konsideruar të pasafatshme dhe të palejuar.

Më tej gjykata ka konstatuar se çështja e lejueshmërisë së ankesës është çështje paraprake e përcaktuar me nenin 134 të LPA-së i cili përcakton se:

"Ankimimet kundër akteve administrative ose mos nxjerrjes së akteve administrative mund të mos pranohen nga organet kompetente të administratës publike në rastet e mëposhtme:

- a) kur ankimet kanë të bëjnë me akte për të cilat nuk lejohet ankimi;
- b) kur afatet kohore për ankimin kanë kaluar;
- c) kur akti administrativ i ankimuar konsiderohet i ligjshëm dhe i rregullt prima facie nga organi që shqyrton ankimin;
- d) kur ankimi paraqitet nga personi i paautorizuar".

Gjykata më tej ka konstatuar se sipas dispozitës së lartcekur, një ankesë e parashtruar pas afatit ligjor, pengon organin administrativ të shqyrtoj ankimin në çfarëdo mënyre tjetër, ndërsa e paditura (OSHP) në rastin konkret ka vendosur dhe për çështjen kryesore, Gjykata ka konstatuar se ankesa do të ishte e pasafatshme dhe e palejueshme vetëm nëse do të ishte e parashtruar pas afatit ligjor pranë të paditurës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimi të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore–Departamenti për Çështje Administrative, të dt: A. nr. 879/16 të datës 03 shkurt 2020 e ka autorizuar ekspertin shqyrtues, që në bazë të nenit 113 të LPP-së, të shqyrtojnë vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 01 tetor 2020, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka përgatitur një kronologji, dhe ka dorëzuar raportin e ekspertizës.

Pas pranimi të kronologjisë paneli shqyrtues ka mbajtur shqyrtimin kryesor me datën 10 tetor 2020, pa prezencën e palëve konform nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 01/20 të dt: 01 mars 2020, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, Aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative dhe Kronologjia e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh kronologjinë e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, ankesën e mëparshme, vendimin, dhe duke u mbështetur në të gjitha provat dhe faktet relevante, konstaton se OSHP ka vlerësuar se ankesa është e pasafatshme pas interpretimit ligjor të institucionit kompetent për mbikëqyrje të afateve kohore dhe publikimeve që bëjnë autoritetet kontraktuese gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të nxjerrë për këto raste.

OSHP e ka konstatuar se paditësi ka tejkaluar afatet ligjore për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-së si dhe nenit 4. 1 paragrafi a) të Rregullave për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim dhe ankesave ku decidivisht thuhet:

*“4. 1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës me postë ose çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj brenda afateve kohore:*

*a) kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit së paku 5 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave;*



*b) kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin për dhënie të kontratës ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej 5 ditëve pas datës së njoftimit që i është dërguar ankuesit.*

Paneli shqyrtues vlerëson se gjykata ka theksuar se e paditura (OSHP) nuk ka qenë dashur të vendosë edhe për çështjen kryesore nëse ka vlerësuar se kanë kaluar afati për ankimim mirëpo paneli sqaron se këtë përgjegjësi OSHP e ka të specifikuar me ligj. Paneli shqyrtues po ashtu vlerëson se konstatimi i gjykatës se: “ankesa do të ishte e pasafatshme dhe e palejueshme vetëm nëse do të ishte parashtruar pas afatit ligjor pranë të paditurës (OSHP-së) nuk është i qëndrueshëm si konstatim pasi që siç është cekur edhe më lartë, OSHP e ka për obligim ligjor, të përcaktuar me ligj dhe rregulla dytësore të vendos me vendim edhe nëse kërkesa për rishqyrtim është e jashtëafatshme.

Paneli shqyrtues konstaton se tani në këtë fazë, edhe po të aprovohet ankesa e operatorit ekonomik dhe lënda të kthehet në rivlerësim apo procedura të kthehet në pikën zero nuk do të kishte kurrfarë efekti juridik pasi që ky aktivitet prokurimi, ky projekt tashmë ka përfunduar.

Prandaj, paneli shqyrtues konstaton se operatorit ekonomik ankues nuk i është shkaktuar kurrfarë dëmi por nëse mund të arrijë të dëshmojë se i është shkaktuar ndonjë dëm, mund ti drejtohet gjykatës kompetente konform këshillës juridike në këtë vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi dhe zbaton Aktgjykimin A. nr. 879/16 të datës 03 shkurt 2020.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – SHSKUK

1x1 OE – Rosa Security

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-se